1	Bojë printeri/fotokopje (zërat 1-41)	copë	Bojrat/tonerat e kërkuar për pajisjet e Autoritetit Kontraktor duhet të jenë <b>origjinale ose ekuivalente</b> , plotësisht të përshtatshme sipas part number-it të prodhuesit. Produktet duhet të jenë të reja, jo të rimbushura, në paketim origjinal të mbyllur, të pajisura me pullë sigurie dhe elementë identifikues. Në rastin e produkteve ekuivalente, operatori ekonomik duhet të garantojë të njëjtën cilësi printimi dhe kompatibilitet, pa dëmtuar pajisjet. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e refuzimit në rast mospërputhjeje.

**\*Shënim:** Në respektim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, në të gjitha rastet kur përmendet **“markë”** pranohet termi **“ose ekuivalent i tij/i saj”**.

**\*Shënim:** Në kuptim të nenit 36 të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve. AK pranon edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN/ISO, mbi konformitetin e standardit evropian, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, në përputhje me përcaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” të Ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 *“Për prokurimin publik”* i ndryshuar, e Nenit 40 pika 2, si edhe të Nenit 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”* i ndryshuar.

*Specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor për argumentimin e fondit limit, hartimin e preventivit, përcaktimin e specifikimeve teknike, si edhe hartimin dhe argumentimin teknikisht dhe ligjërisht të kriterëve të veçanta të kualifikimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si edhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalentii tij/saj”. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.*

Specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentet e procedurës janë hartuar në përputhje me natyrën, funksionin dhe përdorimin e mallrave objekt prokurimi, me qëllim garantimin e cilësisë, qëndrueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre për nevojat e institucionit. Këto specifikime nuk kanë për qëllim kufizimin e konkurrencës, por sigurimin që mallrat e ofruara të përmbushin standardet e kërkuara për përdorim administrativ.

1. Specifikimet teknike për pjesën më të madhe të artikujve objekt prokurimi në **Lotin I**, janë hartuar duke u bazuar në Katalogun “*Blerje Materiale Kancelarie*”, datë 23.10.2025, të publikuar nga Operatori i Blerjeve të Përqendruara. Ndërsa për disa artikuj të veçantë, konkretisht zërat (Nr. 21, 51, 52, 58, 60, 92-95, 97, 105, 106, 119-121, 124, 126, 128-131, 133, 135 dhe 136), të cilët nuk janë të përfshirë në këtë katalog, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar specifikime teknike në mënyrë të pavarur, bazuar në nevojat konkrete, funksionale dhe operative të institucionit, duke respektuar natyrën dhe qëllimin e përdorimit të tyre.
2. Për sa i përket artikujve objekt prokurimi në **Lotin II**, këto lloje bojrash/tonerash janë kërkuar pasi përputhen drejtpërdrejt me printerat dhe fotokopjet ekzistuese që disponon Autoriteti Kontraktor. Kërkesa për këto bojra dhe tonera lidhet drejtpërdrejt me nevojat e përditshme për printim të Autoritetit Kontraktor dhe është e domosdoshme për mbarëvajtjen e pandërprerë të proceseve të punës. Gjithashtu, kërkesa për tonera origjinalë ose ekuivalentë, të rinj dhe jo të rimbushur, synon të sigurojë cilësi në printim dhe të shmangë dëmtimet e pajisjeve. Sasitë janë bazuar në konsumin e vitit të mëparshëm dhe nevojat reale të institucionit.

**Shtojca 7.**

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT****Sasia e mallit që kërkohet:****PREVENTIV****LOTI I – “BLERJE ARTIKUJ KANCELARIE”**

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>	<b>Çmimi për njësi (pa TVSh )</b>	<b>Vlera (pa TVSh )</b>
<b>1</b>	Letër Format A4 80 GSM (210 X 297 MM)	risma 500 fletë	1,245		
<b>2</b>	Letër fotokopje A3	risma 500 fletë	15		
<b>3</b>	Dosje kartoni e thjeshtë	copë	200		
<b>4</b>	Dosje personeli	copë	200		
<b>5</b>	Dosje arkive me lidhëse 15 cm	copë	30		
<b>6</b>	Dosje arkive kartoni me buton 6 cm	copë	55		
<b>7</b>	Dosje arkive kartoni me buton 10 cm	copë	40		
<b>8</b>	Dosje arkive kartoni me buton 12 cm	copë	20		
<b>9</b>	Dosje arkive kartoni buton 15 cm	copë	55		
<b>10</b>	Dosje kartoni me llastik	copë	55		
<b>11</b>	Dosje kartoni me llastik 2 cm	copë	55		
<b>12</b>	Dosje kartoni me llastik 3 cm	copë	20		
<b>13</b>	Dosje kartoni me llastik 5 cm	copë	55		
<b>14</b>	Dosje kartoni me llastik 10 cm	copë	55		
<b>15</b>	Dosje me mekanizem 30 zarfa plastik	copë	20		
<b>16</b>	Dosje me mekanizem 50 zarfa plastik	copë	20		
<b>17</b>	Dosje me mekanizëm, 7cm	copë	30		
<b>18</b>	Dosje arkive kartoni me buton 10 cm	copë	15		
<b>19</b>	Kuti Arkive kartoni standard	copë	130		
<b>20</b>	Korrektor stilo blister	copë	60		
<b>21</b>	Zarfa plastik A4 (100 fije/pako) qese plastike dokumentash	pako	18		
<b>22</b>	Kalkulator 12 digit	copë	2		
<b>23</b>	Kalkulator 16 digit	copë	10		
<b>24</b>	Bllok shënimesh, me 70 fletë	copë	15		
<b>25</b>	Bllok A4 me kapak, imitacion lëkure	copë	15		
<b>26</b>	Bllok A5 me kapak, imitacion lëkure	copë	10		

27	Bllok shënimesh A5 me 60 fletë	copë	10		
28	Goma fshirëse	copë	70		
29	Gërshëre zyre 17-25 cm, dorezë plastike	copë	50		
30	Evidenciator 4 ngjyra	copë	70		
31	Kub plastik me letra shënimesh	copë	5		
32	Kub shënimesh me ngjitje	copë	80		
33	Bllok shënimesh me ngjitje, 100 fletë (letër postite)70x100	copë	140		
34	Ndarëse letre me 40 fletë	copë	50		
35	Prerëse lapsash plastike me depozitë	copë	35		
36	Ngjitës letre (Stik i bardhë) 21 gr	copë	40		
37	Lapsa me gome HB	copë	200		
38	Vinovil minimumi 100-120 gr	shishe	50		
39	Vizore 50 cm	copë	20		
40	Ulluk plastik lidhje 3 mm	copë	10		
41	Ulluk plastik lidhje 6 mm	copë	15		
42	Ulluk plastik lidhje 8 mm	copë	18		
43	Izolant (Shirit ngjitës, letër i bardhë)	copë	45		
44	Stilolapsa të thjeshtë me kapak (Blu)	copë	620		
45	Stilolapsa të thjeshtë me kapak (Zi)	copë	15		
46	Stilolapsa të thjeshtë me kapak (Kuç)	copë	10		
47	Stilolaps rapid, lantu ose ekuivalenti i tij	copë	10		
48	Stilograf	copë	10		
49	Rapidograf 0.5 mm (Blu, Kuq, Zi) (12 copë/pako)	pako	5		
50	Stilolaps cilësor për lidhje marrëveshje	copë	5		
51	Mbajtëse kancelarish rrjete 3 vende (lapsa)	copë	8		
52	Mbajtëse dokumentash metalike 3-she	copë	3		
53	Mbajtëse kancelarie për mjete	copë	8		
54	Bojëra uji me 12 ngjyra me penel	pako	25		
55	Lapustila me ngjyra të ndryshme (Marker permanent Kutu 4 ngjyrëshe)	pako	50		
56	Kartona të bardhë	pako	20		
57	Fletore vizatimi	copë	25		
58	Fletë Dizenjo për vizatim	copë	30		
59	Lapsa me ngjyra vizatimi druri	pako	50		
60	Karton me ngjyra të ndryshme (50 cm x 70 cm)	pako	5		
61	Portamina 0.7MM	copë	3		
62	Maja Portamine 0.5 MM	copë	3		
63	Maja Portamine 0.7 MM	copë	3		
64	CD -R MIN 52 X, 700 MB	kuti	10		
65	DVD-R, 16 x 4.7GB	bobinë	7		
66	Bateri 1.5 V të vogla AAA	copë	50		
67	USB 3.0, 64 GB	copë	8		
68	USB Flash Drive 16 GB 3.0	copë	10		

69	USB 3.0, 128 GB	copë	1		
70	Heqëse teli pincë	copë	3		
71	Makinë heqëse teli e vogël	copë	40		
72	Makina grirëse me kosh, dokumentesh të mëdha	copë	1		
73	Kapse aktesh Nr.3	kuti	10		
74	Kapse aktesh me veshë 15 mm	kuti	60		
75	Kapse aktesh me veshë 19 mm	kuti	35		
76	Kapse aktesh me veshë 25 mm	kuti	75		
77	Kapse aktesh me veshë 32 mm	kuti	60		
78	Kapse aktesh me veshë 41 mm	kuti	55		
79	Kapse aktesh me veshë 51 mm	kuti	70		
80	Makinë qepje dokumentesh 23/20	copë	1		
81	Makinë qepese 24/6	copë	24		
82	Makinë qepëse aktesh 100 fletë	copë	3		
83	Makinë qepëse aktesh 220 fletë	copë	1		
84	Makinë kapëse minimumi 450 fletë	copë	2		
85	Tela për makina kapëse aktesh 23/6	kuti	8		
86	Tela për makina kapëse aktesh 23/8	kuti	10		
87	Tela për makina kapëse aktesh 23/13	kuti	15		
88	Tela për makina kapëse aktesh 23/15	kuti	10		
89	Tela për makina kapëse aktesh 24/6	kuti	150		
90	Tela për makina kapëse aktesh 23/20	kuti	8		
91	Bojë vule blu, kuti plastike	shishe	20		
92	Libër poste 100 faqe model 4	copë	5		
93	Regjister Korespodence (Protokolli) 100 faqe	copë	10		
94	Libër Arke 3 kopje	copë	12		
95	Libër shperndarjesh dokumentash model 4/1	copë	5		
96	Zarfa të vegjel 11x23	copë	500		
97	Zarfa të mesem A4	copë	2,000		
98	Zarfa 16 x 23cm	copë	57,000		
99	Zarfa 30 x 40 cm	copë	10,000		
100	Zarfa 30 x 44 cm	copë	300		
101	Zarfa 44 x 36 cm	copë	400		
102	Zarfa 19 x 26 cm	copë	242		
103	Zarfa 23 x 33 cm (A4)	copë	350		
104	Zarfa 26 x 36 cm	copë	50,500		
105	Zarfa të mëdhenj A4	copë	800		
106	Zarfa A3	copë	260		
107	Axhendë ditore afërsisht 14.2 x 20.5 cm pa logo	copë	15		
108	Dosje konference me kapse të fortë pa logo	copë	30		
109	Kalendar tavoline	copë	10		
110	Marker për CD e zezë ose color	copë	10		
111	Axhendë e vogël A6 (xhepi)	copë	10		
112	Blllok shënimesh me material adesiv 75 x 75 mm	copë	5		
113	Mbajtëse plastike dokumentesh horizontale	copë	4		

114	Mbajtëse dokumentesh 4 sirtarë me çelës	copë	2		
115	Sfungjer për lagie gishti 8 cm	copë	10		
116	Mbajtëse Nadirbandi standard	copë	2		
117	Tampon vule i mesem	copë	6		
118	Kapak transparent për lidhje A4	fije	40		
119	Flete Hyrje 3 kopje nga 30 fletë	blloqe	35		
120	Flete Dalje 3 kopje nga 30 fletë	blloqe	50		
121	Urdhër Dorzimi 2 kopje	blloqe	50		
122	Bexho PVC me clip metalik	copë	2		
123	Kordon për bexho	copë	2		
124	Etiketa adezive të mëdha	kuti	1		
125	Thika të mesme	copë	3		
126	Shkumësa me ngjyra	pako	10		
127	CD-R min 40x90 800 MB, me kapak	copë	20		
128	Ngjyra Uji	pako	40		
129	Letra laminuese A4	pako	10		
130	Penela per bojra akuareli	seri	5		
131	Bojra akrilike 12 ngjyra	pako	25		
132	Bojëra vaji për pikturë	pako	10		
133	Penela per bojra vaji	seri	5		
134	Bojra Uji	pako	30		
135	Lapustila për dërrasë	pako	2		
136	Letër shumëngjyrëshe me xixa	pako	5		
				<b>Vlera pa Tvsh</b>	
				<b>Tvsh 20%</b>	
				<b>Vlera me Tvsh</b>	

### LOTI II – “BLERJE BOJRA/TONERA”

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi (pa TVSh )	Vlera (pa TVSh )
1	Bojë printeri Brother HL-5350-DN	copë	24		
2	Bojë printeri Brother MFC L2752 DW	copë	8		
3	Bojë printeri HP LaserJet MFP M141A	copë	45		
4	Bojë printeri HP LaserJet MFP 1536dnf MFP	copë	4		
5	Bojë printeri HP LaserJet 1018	copë	5		
6	Bojë printeri CANON i-SENSYS LBP2900	copë	3		
7	Bojë printeri Samsung M2022	copë	8		
8	Bojë printeri Samsung M2026 XPRESS	copë	24		
9	Bojë printeri Samsung M2070 XPRESS	copë	24		
10	Bojë printeri Samsung ML2010 PR	copë	4		

11	Bojë printeri Samsung PRO XPRESS M3820 ND	copë	5		
12	Bojë printeri XEROX B205	copë	16		
13	Bojë printeri XEROX B235	copë	8		
14	Bojë printeri LEXMARK B2338	copë	6		
15	Bojë printeri LEXMARK MS310 D	copë	3		
16	Bojë printeri LEXMARK MS312 DN	copë	12		
17	Bojë printeri LEXMARK MX317 DN	copë	10		
18	Bojë printeri RICOH Aficio MP 201SPF	copë	3		
19	Bojë Fotokopje Kyocera FS-1025MFP	copë	4		
20	Bojë Fotokopje Kyocera TaskAlfa 2200	copë	5		
21	Bojë Fotokopje Kyocera TaskAlfa 2553 CI (E ZEZE)	copë	14		
22	Bojë Fotokopje Kyocera TaskAlfa 2553 CI (BLU)	copë	5		
23	Bojë Fotokopje Kyocera TaskAlfa 2553 CI (E VERDHE)	copë	5		
24	Bojë Fotokopje Kyocera TaskAlfa 2553 CI (ROZE)	copë	5		
25	Bojë printeri EPSON EPL6200	copë	1		
26	Bojë Fotokopje XEROX VersaLink C7025 (E ZEZE)	copë	3		
27	Bojë Fotokopje XEROX VersaLink C7025 (BLU)	copë	2		
28	Bojë Fotokopje XEROX VersaLink C7025 (E VERDHE)	copë	3		
29	Bojë Fotokopje XEROX VersaLink C7025 (ROZE)	copë	2		
30	Bojë printeri CANON 545	copë	2		
31	Bojë printeri Brother DCP-1623WE	copë	3		
32	Bojë printeri Brother DCP-L2600D	copë	9		
33	Bojë printeri HP LaserJet Pro 400 M401dne	copë	2		
34	Bojë printeri XEROX Phaser 3124	copë	9		
35	Bojë printeri Brother HL-1112E	copë	3		
36	Bojë printeri RICOH Aficio SP 4310N	copë	1		
37	Bojë printeri Samsung ML1640/1641/1642	copë	4		
38	Bojë printeri XEROX Phaser 3020	copë	3		
39	Bojë printeri Samsung SCX-4623F	copë	1		
40	Bojë printeri Brother HL-1110/1111	copë	4		
41	Bojë printeri Brother HL-L5210DN	copë	5		
				<b>Vlera pa Tvsh</b>	
				<b>Tvsh 20 %</b>	
				<b>Vlera me Tvsh</b>	

**Afatet e lëvrimit: Afati i dorëzimit të mallit është brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga momenti i nënshkrimit të kontratës.**

<b>Artikulli</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Destinacioni</b>	<b>Periudha e dorëzimit</b>
<b>1.</b>	<b>Loti I. “Blerje artikuj kancelarie”</b>	<b>1,517,358.56 (një milion e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë e pesëdhjetë e gjashtë të qindat) lekë pa Tvsh.</b>	<b>Në magazinën e Bashkisë Divjakë</b>	<b>30 (tridhjetë) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.</b>
<b>2.</b>	<b>Loti II. “Blerje bojra/tonera”</b>	<b>880,829.74 (tetëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e nëntë e shtatëdhjetë e katër të qindat) lekë pa Tvsh.</b>	<b>Në magazinën e Bashkisë Divjakë</b>	<b>30 (tridhjetë) ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.</b>



---

## Shtojca 8.

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]*

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### I. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR ÇDO LOT**

### **Loti I. “Blerje artikuj kancelarie”**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Sipas Shtojcës 8, pika 1 “*Kriteret e përgjithshme të për zgjedhjes/kualifikimit*”

##### **2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vjetët e fundit financiarë 2023, 2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

---

**2.2.2** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.*

*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.*

**Shënim:** Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkojnë sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.

*“Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetem fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë SSH/EN/ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

*(Çertifikata si më sipër, duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e AK, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

**Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë Kapacitetin Ekonomik dhe Financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit) si dhe Kapacitetin Teknik (pika 2.3.1 të seksionit 2.3, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit), sa shumatorja e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **II. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR ÇDO LOT**

### **Loti II. “Blerje bojra/tonera”**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

#### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** Sipas Shtojcës 8, pika 1 “Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

---

## 2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

**2.2.1** Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vjetët e fundit financiarë 2023, 2024 dhe 2025 nga shoqëria, ku vlera e xhiros në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026.

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.*

*Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.*

**Shënim:** Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas percaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe percaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike”.

*“Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.*

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) vjetëve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë SSH/EN/ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

*(Çertifikata si më sipër, duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)*

**2.3.3** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e AK, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

**2.3.4** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë me anë të një deklaratë, se tonerat e kërkuar sipas preventivit, duhet të kenë garanci jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i furnizimit.

**2.3.5** Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë me anë të një deklaratë, se tonerat do të jenë bojra origjinale ose ekuivalente, me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura.

**Shënim: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë Kapacitetin Ekonomik dhe Financiar (pika 2.2.1 e seksionit 2.2, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit) si dhe Kapacitetin Teknik (pika 2.3.1 të seksionit 2.3, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit), sa shumatorja e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 9.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
---

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>



Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

## B: DEKLARATA

### Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër<sup>6</sup>.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

<sup>6</sup> Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

## C: DEKLARATA

### Mbi Konfliktin e Interesit

#### Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së

kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

## D: DEKLARATA

### Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:
<ul style="list-style-type: none"> <li>Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.</li> <li>Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.</li> </ul>
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____</i>

### Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

#### A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:  Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u>  Po [ ] Jo [ ]  Nëse, po, numri i punonjësve:  _____  Profili i punonjësve  _____  <u>Makineri e mjete</u>  Po [ ] Jo [ ]  Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:  _____

<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____</p> <p><b>Firma</b> _____</p> <p><b>Vula</b> _____</p> <p><b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>
---

**Ju lutemi sigurohuni që:**

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
